



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1031/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Valon Prebreza kandidat për asamblenë komunale në Fushë Kosovë nga Lëvizja Vetvendosje (LVV) dhe ankesën e Arianit Konjusha antarë i KKZ-së në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si të bazuara ankesat e Anr.1031/2013 dhe Anr.1135 e datës 03.12.2013 të parashtruar nga Valon Prebreza kandidat për asamblenë komunale në Fushë Kosovë nga Lëvizja Vetvendosje (LVV) dhe ankesën e Arianit Konjusha antarë i KKZ-së në Fushë Kosovë

URDHËROHET, KQZ-ja që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrat e Votimit (QV) 0901E,0901X,0902E, 0903E, 0904E, 0905E, 0907E, 0908E 0909E dhe 0910E, vetëm sa ju përket kandidatit të sipërshënuar dhe rezultati të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i, më datën 03.12.2013 ka pranuar ankesat me nr. Anr.1031/2013 dhe Anr.1135 e datës 03.12.2013 të parashtruar nga Valon Prebreza kandidat për asamblenë komunale në Fushë Kosovë nga Lëvizja Vetvendosje (LVV) dhe ankesën e Arianit Konjusha antarë i KKZ-së në Fushë Kosovë në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1031 të datës 03.12.2013, në të cilën kandidati për asamble komunale në Fushë Kosovë nga LVV, pretendon se në rezultatin e shpallur nga KQZ iu është bërë padrejtësi sepse KQZ shpalli fitues kandidatin me 117 vota kurse parashtruesi i ankesës pretendon se ka 121 vota.
Bashkangjitur me ankesën gjenden edhe kopjet e formularëve të KKZ-së.

- Në ankesën Anr. 1135 të datës 03.12.2013, në të cilën Arianit Konjusha anetar i KKZ-së pretendon se kandidati Valon Prebreza me nr 11 ka arritur ti fitoj 121 vota kurse kandidati me nr 7 Elmi Shabani ka arritur te mbledhë 115 vota.
- Parashtruesi i ankesës pretendon se kandidati Valon Prebreza është dëmtuar me 6 vota nga rezultati përfundimtar me çrast te fundit i humbet vendi për asamble komunale.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”*. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat tjera të lëndës e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

- **ankesat janë të bazuara**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga ankesa e parashtruar nga ana e anetarit te KKZ-se është vërejtur se ka pasur parregullsi në QNR. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 1031/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

